
Tribuna sindikale

Nëntor 2005

Dhe drit' e diturisë përpara do na shpjerë





Editorial

EDHE DURIMI YNE KA NJE KUFI

Ka kaluar me shume se nje muaj nga ditet kur te dy sindikatat e arsimit FSASH dhe SPASH zhvilluan takimet e para me Ministrin e Arsimit dhe Shkences, z. Genc Pollo.

Siç eshte bere e ditur, keto ishin takime njohjeje, por njekohesisht edhe takime pune.

Ne keto takime sindikatat e arsimit kerkuan zbatimin e Marreveshjes per rritjen e pagave per vitin 2005 ne masen mesatarisht 15 perqind duke filluar nga 1 Shtatori, fillimin dhe vazhdimin e negocimeve dypaleshe per hartimin dhe nenshkrimin e Kontrates se re Kolektive te Punes dhe hartimin e nje drafti per Statusin e Mesuesit.

Ministri i Arsimit dhe Shkences shfaqi mirekuptim per kerkesat e parashtruara dhe premtoi angazhimin e tij institucional per plotesimin e ketyre kerkesave, gje qe u mireprit edhe nga sindikatat.

Ne pritje te ketyre zgjidhjeve me rruge institucionale, nepermjet bisedimeve dhe dialogut dypalesh, FSASH dhe SPASH e gjykuan te arsyeshme qe te nderpresin ndermarrjen e veprimeve sindikale, per t'i dhene kohe MASH dhe Qeverise qe te njihen me permbajtjen e ketyre kerkesave dhe te bejne pergatitjet e duhura per zgjidhjen e tyre. Ky qendrim i sindikatave te arsimit ishte i drejte dhe eshte mirekuptuar edhe nga masa e sindikalisteve.

Mirepo kjo periudhe mirekuptimi nuk mund te zgjatet pa fund, pa marre rrugezgjidhje kerkesat e parashtruara. Vonesa ka krijuar shqetesim ne bazen sindikale, ne keshillat sindikale ne shkolla dhe seksionet sindikale ne rrethe.

Me te drejte mendohet se tani nuk mund te pritet me gjate, mbasi po i afrohemi fundit te vitit. Eshte koha per te diskutuar per projekt-buxhetin e vitit 2006 dhe punedhenesi nuk ka plotesuar akoma detyrimet e ketij viti. Kerkesa e njezeshme eshte qe te pershpejtohet zgjidhja e kerkesave te parashtruara, sidomos ajo qe ka te beje me masen e rritjes se pagave per vitin 2005, dhe te vendosen afate per Ministrine e Arsimit e Shkences dhe Qeverine per plotesimin e kerkesave te parashtruara.

Kryesite e FSASH dhe SPASH, duke shprehur kete shqetesim te sindikalisteve te bazes dhe te strukturave te tyre deri ne nivelet me te larta, konfirmojne se ka marre fund periudha e qetesise midis dy paleve qe ka sunduar gjate ketyre dy muajve. Ato kerkojne nisjen e menjehershme te dialogut per plotesimin e ketyre kerkesave brenda dates 15 nentor.

Nderkohe sindikatat po shtojne pergatitjet e tyre per organizimin e veprimtarive sindikale ne mbrojtje te kerkesave te tyre te drejta dhe legjitime. FSASH dhe SPASH mendojne se gjate kesaj periudhe dymujore kane qene korrekte dhe shume te pergjegjshme ne marredheniet me Qeverine e re, i kane dhene asaj mundesine dhe kohen e nevojshme per shqyrtimin e kerkesave qe kane qene ne proces me Qeverine e mepareshme. Por plotesimi i ketyre kerkesave te ashtuquajtura ne proces, pra qe rrjedhin nga qeverisja e mepareshme, nuk mund te neglizhohen dhe as te injorohen. Ato kane qene dhe mbeten kerkesa realiste, aspak te ekzagjeruara, por te bazuara ne nje praktike me shume se 7-8 vjecare, te mbeshtetura ne Buxhetin e Shtetit te vitit 2005, larg cdo paragjykimi per forcen politike qe ka qeverisur ose qeveris.

Prandaj ne nenvizojme se askujt nuk duhet t'i shkoje nepermend se mund te abuzohet me durimin, maturine dhe objektivitetin e sindikatave te arsimit. Kur kapercehet kufiri, ato dijne te reagojne dhe te mbrojne kerkesat e tyre te drejta. Kete FSASH dhe SPASH e kane provuar gjate gjithe ketyre viteve te shkuara, kur kane perdorur me shume efekt, si argumentin logjik dhe debatin ne tavoline, ashtu edhe format e larmishme e te fuqishme te levizjes sindikale, derisa kane arritur qellimet dhe objektivat e tyre te drejta. Kjo eshte nje rruge e pandryshuar dhe e vendosur.

PERMBAJTJA

- *Editorial*: Edhe durimi yne ka nje kufi 2
- Angazhim konkret dhe bashkepunim i gjere (*nga Seminari mbi punen e femijeve ne rrethin e Elbasanit*) 3
- FSASH dhe SPASH, aktive ne aktivitetet rajonale 4
- Decentralizimi i shkollës dhe sindikatat *nga Aleks Dushi* 9
- Angazhim per partneritet real dhe efektiv 10
- Nje liber shume i vlefshem per sindikatat 11
- Arritjet jane te mira, por kerkohet me shume 13
- Me kerkesa gjithnje e me te larta *nga Murat Gecaj* 13
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike, *nga Eriona Vangjeli* 15

Kopertina e pare:
Pamje nga Seminari zhvilluar ne Elbasan mbi eliminimin e punes se femijeve

Kopertina e fundit:
Mesues e nxenes te shkolles se mesme "Jeronim De Rada" ne nje aktivitet te perbashket me drejtues sindikale te shkollave te Elbasanit

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 16, Periodike
Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi " Zogu i Pare "
Pallati Ali Kelmendi, kati III,
Tel: 22 83 46
Tel & Fax: 25 65 32

Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

Angazhim konkret dhe bashkepunim i gjere per eliminimin e punes se femijeve

Nga Seminari i zhvilluar ne rrethin e Elbasanit

Ne vazhdim te aktiviteteve ne kuadrin e Projektit qe FSASH e SPASH kane me Sindikaten e Mesuesve te Holandes, AOB, dhe Konfederaten Holandeze te Sindikatave, FNV, ne Elbasan u zhvillua seminari treditor mbi angazhimin e sindikatave te arsimit per parandalimin e punes se femijeve. Ne seminar moren pjese 24 drejtues lokale te FSASH e SPASH, perfaqesues te shkollave te rendesishme ne qytet e ne disa komuna dhe te disa shkollave qe kane me shume probleme ne shkalle rrethi. Ne seanca te posaçme moren pjese edhe perfaqesues te pushtetit lokal (Qarku, Bashkia dhe Drejtoria e Policise se rrethit) dhe nga disa OJQ te angazhuara ne aktivitete konkrete per eliminimin e punes se femijeve. Moren pjese, gjithashtu, ekspertet e Sindikates Holandeze te Mesuesve, AOB, Marten Kirch dhe Trudy Kerperien.



Programi i seminarit ishte shume i ngjeshur dhe interesant, bazuar ne nje kombinim efektiv te shpjegimeve teorike me veprime praktike, diskutime e debate dhe perpunimin e nje plani veprimi per periudhen ne vazhdim.

Ne diten e pare Seminari u hap nga Kryetari i Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, zoti Xhafer Dobrushi, i cili beri nje prezantim te programit te ketij seminari ne kuadrin e aktiviteteve te Projektit dhe zbertheu disa nga synimet qe pritej te realizoheshin gjate tre diteve te zhvillimit te tij.

Pas prezantimit te pjesemarresve, Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Tirane, zonja Shezhi Bedalli, trajtoi temen ne lidhje me konceptin mbi punen e femijeve, standardet nderkombetare, sipas konventave Nr.138 mbi moshen minimale te pranimit ne punesim dhe Nr.182 mbi format me te keqija te punes se femijeve dhe legjislacionin shqiptar mbi mbrojtjen e femijeve dhe punet e rrezikeshme.

Interes te vecante ngjalli tek pjesemarresit Moduli SCREAM, i paraqitur ne seancen ne vijim nga zonja Shezhi Bedalli. Kjo eshte nje pakete shume interesante e cila mund te perdoret nga mesuesit per organizimin e aktiviteteve zbavitese e krijuese, me synim shmangien e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve. Te dyja keto seanca u shoqeruan me aktivitete praktike ku moren pjese ne menyre masive te gjithe pjesemarresit ne seminar.

Ne diten e dyte paradite qendra e zhvillimit te seminarit u spostua ne shkollen 9-vjeçare "Jeronim De Rada" ku moren pjese, jo vetem pjesemarresit e seminarit, por edhe mesues e nxenes te kesaj shkolle, prinder te femijeve qe mesojne ne kete shkolle, perfaqesues te OJF-ve aktive ne aktivitetet e kesaj shkolle si edhe perfaqesuesit nga Holanda.

Ne fillim Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi dhe Sekretari i Pergjithshem i SPASH-it, zoti Defrim Spahiu bene shpjegimet e rastit ne lidhje me angazhimin e ketyre sindikatave per mbrojtjen e femijeve dhe eliminimin e punes se tyre, duke u perqendruar sidomos tek puna konkrete e mesuesve dhe sindikatave ne shkolla, gje per te cilen do te diskutohej edhe ne kete seance ne shkolle.

Ne prezantimin e vete, Kryetarja e SPASH-it per shkollen, zonja Nadire Taka, paraqiti situaten e shkolles, sidomos ne lidhje me braktisjen e saj nga disa nxenes problematike, si edhe perpjekjet qe kane bere sindikatat per nje angazhim konkret te mesuesve per t'u marre me keta nxenes dhe me disa nxenes te tjere qe jane me probleme dhe qe rrezikojne te hyjne ne kete rruge. Nga 675 nxenes qe ka shkolla, theksoi ajo ne prezantimin e vete, jane te angazhuar ne pune te ndryshme duke e braktisur shkollen ose duke vijuar me hope 15 nxenes, nderkohe qe 5 te tjere jane me probleme, 20 nxenes jane me nje prind, 20 te tjere jane me prinder te divorcuar, pothuajse te gjithe keta objekt i nje pune te diferencuar, sidomos nga ana e mesuesve te klasave perkatese ose mesuesve kujdestare.

Drejtori i shkolles, Fatmir Musai, i cili qe ne fillim e mirepriti organizimin e ketij aktiviteti ne shkolle dhe, se bashku me perfaqesuesit e sindikatave, ishte shume aktiv ne pergatitjen e tij, vuri ne dukje se ne kushtet e nje shkolle periferike me nxenes kryesisht nga familje te ardhura rishtaz ne rrethinat e Elbasanit, 168 prej te cilave me asistence dhe 60 familje me origjine egjiptiane, drejtorise dhe stafit pedagogjik te shkolles i eshte dashur te beje shume, jo vetem per pervetesimin e programeve mesiomre, por edhe per edukimin e nxenesve, shmangien e braktisjes se shkolles ose te vijimit me hope. Ai kerkoi me shume nga sindikatat e shkolles, nga seksionet sindikale ne rreth dhe nga organet qendrore te FSASH-it e SPASH-it per te bere me shume presion mbi Ministrine e Arsimit dhe Drejtorine Arsimore per me shume investime per nxenesit dhe mesuesit e shkolles, me qellim qe ata te motivohen per nje pune me cilesore dhe me rezultative ne oren e mesimit, por edhe jasht saj.

Mesuesja Elvira Leci paraqiti, ne vijim, pervojen e saj me nxenesit me probleme dhe rezultatet emocionuese qe u pranuan edhe nga vete nxenesit e pranishem ne salle.

Vijon në faqen 4

Angazhim konkret dhe bashkepunim i gjere per eliminimin e punes se femijeve

Vijon nga faqja 3

Shembuj te tille dhane edhe zv/Drejtorja Blerta Tahiraj dhe mesuese te tjera te kesaj shkolle, si edhe prinder e nxenes pjesemarres ne aktivitet.

Drejtuesit e FSASH-it e SPASH-it dhe perfaqesuesit e AOB vleresuan pervojen e kesaj shkolle dhe e konsideruan ate si nje shembull i mire per nje pune edhe me rezultative, jo vetem ne kete shkolle, por edhe ne shkollat e tjera te ketij rrethi.

Seanca e mbasdites, e zhvilluar ne sallen e seminarit, u perqendrua gjeresisht tek puna e dy sindikatave te arsimit te ketij rrethi dhe tek nevoja per nje koordinim e bashkepunim me te mire me Drejtorine Arsimore, me organet e pushtetit lokale, (Prefekture, Qark e Bashki), si edhe me organizatat e tjera joqeveritare qe jane aktive per keto probleme ne Elbasan.

Ne emer te Grupit te Punes qe funksionon ne kete rreth ne kuadrin e Projektit me AOB - FNV, Kryetarja e seksionit sindikal te SPASH-it per Elbasanin, zonja Bukuroshe Shabani, paraqiti situaten, problemet dhe disa nga detyrat kryesore per te ardhmen.

Dy seancat e dites se trete ishin, gjithashtu, interesante dhe efektive. Ne seancen e pare ekspertet holandeze paraqiten pervojen e AOB ne punen me nxenesit me probleme dhe angazhimin e mesuesve per parandalimin e punes se femijeve, duke theksuar se ky problem nuk eshte i pranishem vetem ne Shqiperi, por kudo, edhe ne Holande, ku gjendet sidomos ne poçeri, ne bujqesi dhe ne miniera. Zoti Marten Kirch theksoi, gjithashtu, se ky problem eshte ekonomik, qe lidhet me varferine, por ne te njejten kohe ai eshte po aq, ne mos me shume edhe ceshtje mentaliteti, prandaj puna e sindikatave duhet te perqendrohet ne te dyja keto aspekte. Me tej, ai vleresoi angazhimin e mesuesve te rrethit te Elbasanit, ne lidhje me kete çeshtje, pavaresisht nga ngarkesa e madhe qe kane ne procesin mesimor dhe pagat e ulta, duke u ndalur edhe ne shpjegimin e konceptit holandez mbi femijerine, si nje çeshtje qe nuk duhet te kufizohet vetem tek te mesuarit ne shkolle, por edhe tek plotesimi i kerkesave te shumta qe lidhen me interesat e femijeve ne kushtet e kohes kur jetojme. Ai theksoi rolin e rendesishem te sindikatave te arsimit, te cilat duhet te mos priren nga projekte te medha, por te fillojne te punojne me programe te vogla ne disa shkolla pilot, duke organizuar aktivitete zbavitese e terheqese jo shume te kushtueshme me synimin e zgjerimit te tyre ne te ardhmen.

Ne seancen e fundit te gjithe pjesemarresit ne seminar raportuan mbi gjendjen ne shkollat perkatese dhe bene propozime per planin e veprimit, ne kuadrin e te cilit u percaktuan disa nga drejtimet kryesore te punes per te ardhmen. Duke bere konkluzionet e kesaj seance, dhe te seminarit ne teresi, zoti Xhafer Dobrushi e vuri theksin tek disa nga detyrat e nguteshme e konkrete te te dy seksioneve sindikale ne shkalle rrethi dhe te vete sindikatave ne shkolla, sidomos per evidentimin me te mire te gjendjes dhe organizimin e punes konkrete me nxenesit qe kane braktisur shkollen ose qe jane ne rrezik per ta braktisur ate, tek organizimi i nje pune te vecante me nxenesit me probleme, zgjerimi i aktiviteteve edukuese e shlodhese me nje pjesemarrje sa me te gjere te nxenesve, si edhe forcimi i bashkepunimit me Drejtorine Arsimore Rajonale dhe me organet e pushtetit lokale dhe OJF-te per terheqjen ne shkolla ose per perfshirjen ne forma te tjera kualifikimi te femijeve qe jane te angazhuar ne pune.

Duke reflektuar per verejtjet e drejta qe u bene nga pjesemarresit ne seminar, z. Dobrushi

nenvizoi angazhimin e dy sindikatave te arsimit me rastin e diskutimit te projekt-buxhetit te vitit 2006, me qellim qe te miratohen edhe disa fonde per paisjen e shkollave me disa vegla muzikore ose sportive, qe sot mungojne.

Stavri LIKO
Kordinator i Projektit



Ajo u ndale kryesisht tek nxenesit qe kane braktisur shkollen ne qytet e ne komuna, shkaqet e kesaj gjendjeje (varferia, mentaliteti, problemet e prinderve) dhe nenvizoi vlerat e perfshirjes se sindikatave te arsimit te Elbasanit ne aktivitetet e Projektit me AOB – FNV.

Me tej, kryetari i seksionit te FSASH per Elbasanin, zoti Osman Nika beri disa shpjegime ne lidhje me domosdoshmerine e motivimit me te mire te mesuesve per t'u marre ne menyre te diferencuar me keto probleme, duke shfrytezuar edhe rastin e negociat-

FSASH dhe SPASH, aktive në aktivitetet rajonale

Nga aktivitetet e zhvilluara në Beograd

Dy aktivitete të rëndësishme u zhvilluan në Beograd nga Struktura Pan-Evropiane dhe Komiteti Evropian i Sindikatave për Arsimin, (ETUCE): Seminari mbi zbatimin e kërkesave të Deklaratës së Bolonjës për arsimin e lartë dhe Konferenca Rajonale me temë " Reforma Arsimore dhe Sindikatat e Vendeve të Evropës Qendrore e Lindore ".

Në këto aktivitete morën pjesë drejtuesit kryesorë të sindikatave të arsimit të këtyre vendeve, si edhe përfaqësues të sindikatave më të përparuara të perëndimit e të vendeve skandinave.

Në të dyja këto aktivitete sindikatat e arsimit të vendit tonë, FSASH dhe SPASH, u përfaqësuan nga titullarët e tyre, Z. Xhafer Dobrushi dhe Z. Bajram Kruja.



Metoda që u perdorë në të dyja aktivitetet ishte një kombinim i raportimeve të përfaqësuesve të sindikatave të këtyre vendeve, me disa tema që u zhvilluan nga Kordinatorët e Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, EI, Monique Fouilhoux dhe Guntars Catlaks, të pasuara nga diskutime në grupe e në seanca plenare.

Kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrushi, foli në emër të sindikatave shqiptare, në lidhje me ecurinë e procesit të Bolonjës në vendin tonë dhe problemet me të cilat përballen sindikatat shqiptare në këtë proces.

Ndër të tjera, në ndërhyrjen e vetë, zoti Xhafer Dobrushi theksoi:

Shqipëria është përfshirë në procesin e Bolonjës në vitin 2002, kështu që eksperienca jonë në këtë drejtim është shumë modeste. Në vijim të nënshkrimit të Deklaratës së Bolonjës, është miratuar Ligji për Arsimin e lartë, i cili reflekton kërkesat e procesit të Bolonjës në përgjithësi, përfshirë edhe nivelet e gradave, sistemin e akreditimit etj.

Në vendin tonë ekzistojnë 10 qendra universitare. Disa prej tyre, përfshirë Universitetet e Tiranës, Universitetin Politeknik, Akademinë e Arteve dhe Universitetin e Shkodrës janë të konsoliduar, sepse kane edhe staf akademik të kualifikuar. Ndërsa gjendja është me e vështirë për universitetet e reja, vecanërisht për ato të rretheve, për të plotësuar relativisht shpejt e me cilesi kërkesat e procesit të Bolonjës.

Arsimi i lartë është shumë masiv në Shqipëri. Rreth 70 përqind të nxënësve që mbarojnë arsimin e mesëm vazhdojnë arsimin e lartë. Këtë vit shkollor kjo shifër është edhe më e lartë, deri në 80 përqind, si rezultat i një ndërhyrjeje të qeverisë për të rritur kuotat në degë të ndryshme të universiteteve në Tiranë e në rrethe.

Eshtë e rëndësishme që në procesin e zbatimit të Deklaratës së Bolonjës universitetet më të konsoliduara të Shqipërisë kanë vendosur lidhje bashkëpunimi

Vijon në faqen 6

FSASH dhe SPASH, aktive në aktivitetet rajonale

Vijon nga faqja 5

me disa universitete të vendeve të perëndimit, sidomos në Itali (Universitetet e Romës, Barit dhe Bolonjës), në Austri (universiteti i Gracit), në Gjermani etj.

Në lidhje me Ligjin mbi arsimin e lartë dhe procesin e Bolonjës, në vendin tonë ka dy probleme evidente: Ligji ka disa mungesa e dobësi dhe ka akoma shumë vështirësi në procesin e zbatimit të tij.

Sindikatat e arsimit të lartë në vendin tonë po përballen me tre probleme, mbas një periudhe dy vjecare të përpjekjeve për zbatimin e procesit të Bolonjës:

1. Ligji nuk e ka zgjidhur problemin e buxhetit për arsimin. Edhe pse arsimi është konsideruar si sektor prioritar nga qeveria e mëparshme, pjesa e GDP për arsimin ka qenë shumë e ulët, nga 2.8 deri në 3 përqind, gjatë këtyre 4-5 vjetëve të fundit, e cila është një nga më të ultat në rajon.

2. Pagat e stafit të pedagogëve kanë qenë shumë të ulta, gjë që ka shkaktuar shumë probleme, për faktin se disa prej tyre kanë tentuar për të gjetur vende të tjera pune brenda vendit ose janë larguar jashtë shtetit për kushte më të mira.

3. Autonomia e universiteteve nuk po realizohet akoma.

Në këto kushte, sindikatat tona në arsimin e lartë ndërmorën gjatë vitit 2004 një aktivitet të gjerë sindikal, duke kërkuar tregues më të mirë në lidhje me të tre problemet e mësipërme. Ato organizuan një grevë me shumë se trejavore, pas dështimit të negociimeve me qeverinë. Si rezultat, ato arritën një marrëveshje për rritjen e pagave nga 60 deri në 100 përqind, gjë që do të thotë që pagat e stafit pedagogjik janë ngritur tani në nivelet 400 Euro në muaj më e ulta dhe deri në 900 Euro në muaj për profesorët.

Qeveria e re e koalicionit të djathtë, ka premtuar, ndërkohë, që të dyfishojë pjesën e GDP për arsimin dhe, si rrjedhojë, edhe pagat e punonjësve të arsimit, deri në fund të periudhës katërvjecare të mandatit të saj.

Të dy sindikatat e arsimit në Shqipëri, FSASH dhe SPASH, janë të angazhuara dhe do të vazhdojnë të jenë një faktor i rëndësishëm, vecanërisht në arsimin e lartë për zbatimin e detyrimeve që lindin nga procesi i Bolonjës.

Duke përfituar edhe nga diskutimet dhe konkluzionet e kësaj Tryeze të Rrumbullakët, ato do të përmirësojnë më tej punën e tyre edhe në lidhje me bashkëpunimin me organizatat e studentëve, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm edhe në universitetet shqiptare.

Të dyja aktivitetet dolën me rezoluatat përkatëse, të cilat po i botojmë në vijim:

Rekomandime të Seminarit mbi Procesin e Bolonjës:

Tridhjete përfaqësues nga Shqipëria, Kroacia, Letonia, Polonia, Rumania, Rusia, Serbia e Mali i Zi, Sllovakia dhe Sllovenia morrën pjesë në Beograd në një seminar të organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit për Rajonin Europian dhe diskutuan situatën e zbatimit të procesit të Bolonjës dhe sfidat e ardhshme.

- Ata mirëpritën vlerësimin e rolit të stafit akademik në Komunikatën e Bergenit dhe përfshirjen e Strukturës Pan-Europiane të Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, si një anëtare konsultative në Grupin e Ndjekjes së Zbatimit të Procesit të Bolonjës.
- Ata vërejtën ndryshimet domethënëse që kanë ndodhur në rajonin Europian me zbatimin e procesit të Bolonjës dhe prioritetet e përcaktuara në Bergen për dy vitet në vazhdim.
- Ata rikujtuan që procesi i Bolonjës nuk sjell vetëm mundësi, por edhe sfida për komunitetin akademik.
- Ata përsëritën që arsimi i lartë është një shërbim publik dhe se është përgjegjësia e Shtetit të investojë dhe të sigurojë mundësi të barabarta pranimi, bazuar në aftësitë akademike.
- Ata theksuan se ka një marrëdhënie të ngushtë midis kualifikimeve dhe kushteve të punës të stafit akademik dhe cilësisë të arsimit të lartë.

Pjesëmarrësit kërkuan nga organizatat Anëtare të Federatës Ndërkombëtare të Arsimt, EI:

- T'u kërkojnë Qeverive dhe Institucioneve të njohjin sindikatat e stafit akademik si partnere të plota dhe t'i përfshijnë ato në strukturat e ndryshme që merren me ndjekjen e zbatimit të procesit të Bolonjës, si edhe të mbështesin përfshirjen në këto struktura edhe të sindikatave të studentëve.
- Të krijojnë ose për-

forcojnë marrëdhëniet e punës me organizatat e studentëve.

• Të mbështesin Konventën e UNESCO-s dhe Këshillit të Europës të miratuar në Lisbon.

• Të mbrojnë lidhjen e pandashme midis mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore.

• Të kërkojnë të drejtën e sindikatave të stafit akademik për t'u angazhuar në marrëveshjen kolektive për përmirësimin e kushteve të punësimit të tyre.

Pjesëmarrësit kërkuan nga Qeveritë/ Institucionet:

• Të Përfshijnë Sindikatat e stafit akademik në strukturat kombëtare që merren me zbatimin e procesit të Bolonjës, në zbatim të vendimit të Konferencës së Ministrave për të përfshirë në këto struktura Federatën Ndërkombëtare të Arsimit, EI.

• Të konsultojnë sindikatat e stafit akademik mbi përmbajtjen e raporteve ndërkombëtare për Konferencat e Ministrave ose mundësisht t'i përfshijë ato në "grupet që përgatisin draftet".

• Të sigurojnë që Komunikata e Bergenit dhe dokumentat që lidhen me të, të përkthehen dhe që raportet kombëtare të përpunohen në gjuhët amëtare.

• Të zbatojnë Konventën e UNESCO-s dhe Këshillit të Europës të miratuar në Lisbon.

• Të trajtojnë çështjet e kushteve të punës dhe të lëvizjeve të stafit akademik, veçanërisht nevojën për trajnim dhe përgatitje profesionale për një zbatim të përshtatshëm të reformave të nevojshme.

• Të ruajnë lirinë akademike dhe të sigurojnë një balancë të përshtatshme midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

• Të caktojnë financime të përshtashtme publike për të siguruar zbatimin e duhur të procesit të Bolonjës dhe për të evituar privatizimin dhe komercializimin e arsimit të lartë.

Pjesëmarrësit kërkuan nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit për Rajonin Europian:

• T'i japë prioritet të lartë mundësisë që sindikatat e arsimit të lartë dhe të kërkimeve shkencore të përfshihen në Komitetin e Përhershëm të Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore (HERSC) dhe në rrjetin elektronik të Komitetit Europian të Sindikatave të Arsimit, ETUCE.



Rezolutë e Tryezës së Rrumbullakët për organizatat anëtare nga Europa Qendrore dhe Lindore

Organizatat anëtare të Federatës Ndërkombëtare të Arsimit për Europën Qendrore e Lindore, që përfaqësojnë katër milion mësues e punonjës të tjerë në arsim, që u takuan në Beograd, në datë 6 deri në 8 tetor 2005:

Njohën që:

• Çdo njëri ka të drejtën e një arsimimi cilësor të përshtatshëm.

• Arsimimi me cilësi të lartë është çelësi për zhvillimin social dhe ekonomik.

• Mirëqënia e vendeve lidhet me nivelet e arsimimit të qytetarëve të tyre.

• Kohezioni social, stabiliteti dhe vlerat demokratike ushqehen më mirë nëpërmjet arsimit cilësor, dhe

• Prandaj arsimi është një shërbim publik dhe, si i tillë, duhet të financohet dhe të administrohet në bazë të rregullave publike.

• Arsimimi duhet të organizohet në mënyrë që të sigurojë mundësi për njerëzit e të gjitha moshave dhe aftësive për t'u zhvilluar deri në kapacitetet e tyre maksimale, në kontekstin e të mësuarit gjatë të gjithë jetës.

Vijon në faqen 8

FSASH dhe SPASH, aktive në aktivitetet rajonale

Vijon nga faqja 7

• Arsimimi me cilësi të lartë duhet të arrijë një ekulibër midis përgatitjes së njerëzve për jetën si qytetarë aktivë në shoqëritë demokratike, transmetimit të njohurive e aftësive dhe zhvillimit të kapaciteteve të të menduarit kritik dhe përgatitjes së njerëzve për tregun e punës.

• Mësuesit dhe punonjësit e tjerë të arsimit dhe organizatat e tyre përfaqësuese janë një burim shumë i rëndësishëm ekspertize e njohurie për të ndihmuar dhe mbështetur zhvillimin e sistemeve të arsimit cilësor nga ana e qeverive dhe autoriteteve e tjera përgjegjëse publike.

• Shërbimet e arsimit publik cilësor varen nga mësuesit dhe profesionistët e tjerë të trajnuar dhe të shpërblyer mirë, të cilët punojnë në kushte të mira.

Mirëpritën arritjet e deritanishme të procesit të Bolonjës, sepse ai siguron mundësi më të mëdha për lëvizjen e mësuesve e studentëve dhe për njohje të ndërsjellë të diplomave e kualifikimeve të tjera.

Kundërshtuan pirjet ndërkombëtare, veçanërisht ato të Marrëveshjes së Përgjithshme të Shërbimeve të Tregtisë, GATS, që synojnë të paraqesin shërbimet e arsimit si komoditete që mund të blihen e shiten në tregun botëror.

Kërkuan që qeveritë dhe autoritetet e tjera publike:

• T'i japin prioritetin më të lartë financimit për krijimin e mundësive të arsimimit për të gjithë dhe, në këtë kontekst, që të gjitha qeveritë e vendeve të Europës Qendrore e Lindore të ngrenë menjëherë përqindjen e GDP për shpenzimet në arsim deri në nivelet mesatare të Komunitetit Europian.

• Të vendosin rregulla për të siguruar që shërbimet e arsimit të plotësojnë standardet më të larta.

• Të angazhohen në kontratën kolektive me përfaqësuesit e mësuesve dhe punonjësve të tjerë në arsim për përmirësimin e kushteve të tyre të punës.

• Të njohin kontributin jetësor të mësuesve e punonjësve të tjerë në arsim për suksesin e sistemit të arsimit duke bërë të mundur që ata të shpërblehen siç duhet për punën e tyre.

• Të braktisin politikat e decentralizimit dhe privatizimit që janë krijuar për t'iu shmangur përgjegjësisë së tyre për të siguruar shërbime të përshtatshme në arsim.

• Të konsultojnë përfaqësuesit e mësuesve e punonjësve të tjerë në arsim për zhvillimin e politikave e dispozitave të arsimit dhe në veçanti në lidhje me përmbajtjen e raporteve kombëtare të EU-së që duhet të jenë të disponueshme në gjuhën amëtare.

Kërkuan që organizatat qeveritare ndërkombëtare si OECD, UNESCO, ILO dhe EU:

• Të zbatojnë marrëveshjet e tyre ndërkombëtare, deklaratat dhe instrumentat që përcaktojnë të drejtën për t'u arsimuar dhe të drejtën e mësuesve e punonjësve të tjerë të arsimit për të krijuar sindikata dhe për të rënë negocuar në mënyrë kolektive.

• Të konsultojnë zyrtarisht përfaqësuesit e mësuesve e punonjësve të tjerë të arsimit në nivel ndërkombëtar për hartimin e politikave të arsimit dhe mjeteve të kërkimeve studimore, siç janë pyetësorët.

Mbështetsin kolegët e tyre të SOK në Maqedoni në përpjekjet e tyre për të ruajtur rolin që kanë në përfaqësimin e anëtarëve të tyre dhe të interesave të arsimit.

Mbështesin kolegët e tyre të EGITIM SEN në Turqi në përpjekjet e tyre për të ruajtur njohjen ligjore dhe të drejtën për të përfaqësuar anëtarët e tyre.

I bëjnë thirrje Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, EI, për të vazhduar përpjekjet:

• Për të përkrahur arritjen e Arsimimit Publik Cilësor Për Të Gjithë në vendet në tranzicion në Europë.

• Për të bindur organizatat ndërkombëtare që të insistojnë për të zbatuar standardet dhe konventat e tyre, të cilat i detyrojnë qeveritë kombëtare në lidhje me të drejtën për arsimim, njohjen e statusit të mësuesve dhe të drejtave sindikale të mësuesve e punonjësve të tjerë të arsimit.

• Për të mbështetur organizatat e saj anëtare në Europën Qendrore dhe Lindore në përpjekjet e tyre për të fituar njohjen si partnerë në zhvillimin e sistemit të tyre arsimor, dhe

• Për t'u siguruar ndihmë urgjente atyre organizatave ekzistenca e të cilave është e kërcënuar.

Decentralizimi i shkollës dhe sindikatat

Decentralizimi i arsimit tani është një nga problemet e shtruara për zgjidhje, por që nuk mund të kuptohet ndryshe veçse si pjesë e decentralizimit të përgjithshëm të pushtetit në vendin tonë. Nga ngarkesa që ka marrë kjo fjalë mendoj se duhet të jetë objekt i një diskutimi të kujdesshëm. Shpesh decentralizimi kuptohet si një veprim që do të zgjidh problemet e shumta që ka sot arsimi shqiptar, ndërsa centralizimi si e kundërta. Në dokumentin zyrtar për decentralizimin, kur flitet për avantazhet dhe disavantazhet e decentralizimit thuhet se: përbën avantazh sjellja e shërbimeve me afër komunitetit, ndërsa tek disavantazhet, cilësia e shërbimeve mund të përkeqësohet. Avantazhi dhe disavantazhi që përmendëm më lart na bën të qartë se decentralizimi dhe centralizimi nuk duhen parë si dy gjëra të kundërta. Këto duhen parë si plotësuese të njëra tjetrës. Këtu s'mund të flitet për përjashtime, por për nivel të decentralizimit dhe të centralizimit.

Duke folur për decentralizimin, mendoj se nuk duhet kuptuar si thirrje për të eliminuar probleme, por si një ftesë për të përmirësuar arsimin ose më mirë si një projekt ku secili të jetë pjesë e zhvillimit. Gjithësesi shkolla është një shërbim, por jo i zakonshëm. Është një shërbim që u bëhet individëve, grupeve, mësuesve dhe nxënesve, komunitetit, vendit dhe mbarë Kombit. Them se nuk mund të ketë diçka tjetër më një shtrirje kaq të gjerë dhe të rëndësishme. Të gjithë atyre që u ofrohet shërbimi i shkollës duhet të jenë pjesë e këtij diskutimi. E parë në këtë vështrim, raporti ndërmjet decentralizimit dhe centralizimit duhet të jetë pjesë e një strategjie mbarëkombëtare të zhvillimit arsimor. Për të realizuar këtë, duhet një pjesëmarrje e gjerë në mënyrë që të ndërtohet një lidhje ndërmjet prindërve, mësuesve, nxënësve pushtetit lokal dhe atij qëndror, specialistëve etj. Ky proces duhet të paraprihet nga ligje, rregulla e, mbi të gjitha, kërkohet një menaxhim i situatës për kualifikimin paraprak të të gjithë atyre që do të jenë pjesë e këtij decentralizimi.

Ka lëvizje të fuqishme si ajo e shoqatës së kryetarëve të bashkive e cila kërkon një decentralizim të shpejtë dhe sa më të plotë. Problemet kryesore shihen në drejtimin ekonomikë, të cilat siç thamë dhe më lart, nuk mund të realizohen pa një decentralizim të përgjithshëm e të gjithanshëm të pushtetit vendor. Në një material të paraqitur kur përmendin aktorët pjesëmarrës nuk përmendin fare sindikatat e mësuesve. Megjithatë sindikatat janë shumë të interesuara për proçesin e decentralizimit. Si përfaqësuese të mësuesve, ato janë një pjesë shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme. Duke realizuar decentralizimin, edhe roli i sindikatave forcohet në bazë komune, bashkie dhe në bazë shkolle. Roli i tyre i drejtëpërdrejtë aty ku ofrohet shërbimi bën që sindikatat jo vetëm të ofrojnë kontributin e tyre, por edhe të jenë pjesë e vendimmarrjes.

Sindikatat janë të interesuara për raportin ndërmjet decentralizimit dhe reformës në arsim. Duke mos i konsideruar si i njejti proçes, por që zhvillohen njëkohësisht, dëshiroj të ndalem në disa probleme që kanë të bëjnë me decentralizimin:

a. Drejtimi i shkollës, i cili nuk duhet kuptuar vetëm si punë e drejtuesve, por duhet të kombinohet me kontributin dhe rolin e komunitetit. Duhet të bëhet e qartë se kush do t'a drejtojë dhe si duhët ta drejtojë shkollën. Është e çuditshme të thuhet se arsimi i një rrethi me mbi 2000 mësues drejtohet nga një drejtor. Ai emëron, drejton, transferon, etj. Është po kaq e quditëshme nëpoftëse këtë p.sh. propozohet ta bëjë komuna. Roli i Bordit të shkollës mund të jetë i rëndësishëm. Qëllimi është që të ndërtohet një mjedis kuvlerësimi të jetë rezultat i veprimtarisë në shkollë.

b. Menaxhimi ekonomik, në të cilin mendoj se duhet të mbizotërojë decentralizimi drejt bordit të shkollës. Është e patoleruershme të mos realizohet sa më parë kjo gjë. Këtu duhet të soparojmë diçka që ka të bëjë me ndryshimin ndërmjet sigurimit të fondeve dhe menaxhimit të tyre. Këtu duhet të konsiderohet se ndryshimi u përket të gjithëve. Mësuesit, nxënesit, prindërit, të gjithë duhet të ndjehen pronarë dhe krenarë për arritjet. Shkolla i përket komunitetit keshtu dhe kujdesi për të i përket pikërisht atij.

c. Ndryshimet në brendësinë e të mësuarit dhe zhvillimi i kurrikulave. Meqenëse ky problem ka të bëjë me të gjitha standardet që, në një farë mënyre, janë kombëtare, kjo gjë realizohet në rang institucionesh qendrore e lokale. Mendoj se mësuesët, si profesionistë, duhet të kenë një formim mbi standarde kombëtare, por secili të ketë të drejtë të shprehë dhe të përdorë opsionet e veta. Këtu ka një problem që ka të bëjë me një qendrim të dyfishtë të drejtorive arsimore. Nuk mund të ketë të drejtë një institucion të emërojë, të kualifikojë dhe të kontrollojë.

Problemi i decentralizimit është mjaft i gjërë dhe kërkon mendime nga sa më shumë njerëz. Ndosha dhe Revista "Tribuna Sindikale" mund të hapë një rubrikë për këtë problem. Sindikalistët kanë interesa të drejtëpërdrejta me këtë problem, jo vetëm si mësues, por dhe si pjesë e shoqërisë civile.

Aleks Dushi
Mesues Shkodër

Angazhim për partneritet real dhe efektiv

Nga Takimi i Kryesisë së FSASH me Ministrin e Arsimit dhe Shkencës

Në zbatim të detyrave që u shtruan në Këshillin Drejtues dhe në vijim të përpjekjeve për të realizuar tre kërkesat kryesore për të cilat është rënë dakord që në vitin e kaluar shkollor, Kryesia e Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, e kryesuar nga Kryetari i Federatës, zoti Xhafer Dobrushi, bëri një Takim pune me Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, zotin Genc Pollo.

Në emër të Kryesisë dhe të Këshillit Drejtues, zoti Dobrushi e informoi Ministrin mbi aktivitetin dhe angazhimet e FSASH dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar, si palë ligjore dhe partnerë seriozë, për zhvillimin cilësor të arsimit dhe mbrojtjen e interesave social ekonomike të mësuesve e pedagogëve. Ai shprehu, gjithashtu, mbështetjen për të gjitha veprimet e strukturave të Ministrisë për të goditur veprimet korruptive të drejtuesve të arsimit, të administratës së këtij sektori, në radhët e mësuesve, për rritjen e përgjegjësisë dhe të etikës së tyre në procesin mësimor e jasht tij dhe për të shmangur veprimet e paligjshme te drejtuesve të arsimit në nivel lokal, sidomos në lidhje me lëvizjet dhe transferimet e pajustifikuara të mësuesve e të drejtuesve të shkollave.

Pasi vuri në dukje edhe përvojën e bashkëpunimit me Sindikatën e Pavarur të Arsimit Shqiptar, SPASH, jo vetëm përsa i përket mbrojtjes së interesave social ekonomike të mësuesve, por edhe për modernizimin e arsimit, për rritjen e rolit të mësuesve për mbrojtjen e fëmijëve dhe demokratizimin e shoqërisë shqiptare në tërësi, për të cilat janë në zbatim projekte të përbashkëta, zoti Xhafer Dobrushi, parashtroi tre kërkesat konkrete të FSASH për periudhën afatshkurtër, të cilat janë: Zbatimi i Marrëveshjes së arritur në muajin prill të këtij viti, me Qeverinë e mëparëshme, për rritjen e pagave të mësuesve në arsimin parauniversitar në masën 15 përqind, duke filluar nga 1 shtatori 2005, vazhdimin e negocimeve dhe nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive të Punës dhe miratimin e Statusit të Mësuesit.

Duke e marrë fjalën në Takim, anëtarët e tjerë të Kryesisë trajtuan probleme të veçanta, që i preokupojnë ata në seksionet përkatëse.

Zv/Kryetari i Federatës dhe Kryetar i seksionit Sindikal të Vlorës, zoti Petref Çelaj, shtroi kërkesën për një angazhim më të mirë të strukturave të Ministrsië, përfshirë Drejtoritë Rajonale, sidomos për ruajtjen e ekuilibreve në ndërtimin e shkollave të reja në zonat rurale dhe ato urbane, mbasi vihet re një disproporcion i madh përsa i përket numrit të nxënësve në klasa, sigurimit të mësuesve me arsim përkatës, sidomos në disa shkolla të mesme në komunat periferike. Ai ngriti, gjithashtu, problemin e marrjes së godinës së ish Shkollës së Naftës, për të hapur një shkollë të re të mesme në qytetin e Vlorës, e cila do të lehtësonte ngarkesën e nxënësve në klasa, që aktualisht është 45-55 nxënës.

Zv/Kryetare e Federatës dhe Kryetare e Seksionit Sindikal të Tiranës Qytet, zonja Fatbardha Keço, kërkoi miratimin e akteve nënligjore që lidhen me zbatimin e disa çështjeve të Kontratës Kolektive që zbatohen me vështirësi ose kundërshtohen nga segmente të veçanta të strukturave të arsimit në rrethe.

Edhe Zv/Kryetarja Lumturi Mataj dhe Zv/Kryetari Berti Çaprazi, ngritën probleme konkrete që lidhen me përmirësimin e punës së drejtorive arsimore, sidomos në emërimin e inspektorëve të aftë e të specializuar sipas lëndëve përkatëse dhe për një bashkëpunim e partneritet më efektiv me sindikatat.

Që në fillim të fjalës së vetë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Genc Pollo, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me përfaqësuesit e sindikatave për të realizuar objektivat e programit të Qeverisë për zhvillimin e arsimit. Ai shprehu angazhimin për t'i mbështetur mësuesit në kërkesat e tyre të drejta për rritjen e pagave, duke theksuar se, mbi bazën e rritjes së të ardhurave nga tatimet e doganat dhe nga burime të tjera, do të bëhet e mundur rritja graduale e buxhetit të arsimit deri në dyfishimin e tij brenda katër vjetëve, gjë që do të çojë edhe në rritjen graduale të pagave të mësuesve deri në dyfishimin e tyre gjatë kësaj periudhe katërvjeçare. Duke iu përgjigjur drejtpërdrejt kërkesës për zbatimin e Marrëveshjes për rritjen e pagave të mësuesve në sistemin parauniversitar me 15 përqind duke filluar nga 1 shtatori 2005, ai theksoi se do të punojmë me këmbëngulje, duke rakorduar me Ministrinë e Financave dhe me strukturat e tjera përkatëse, për ta bërë të mundur realizimin e kësaj kërkese.

Në lidhje me këtë çështje, u ra dakord që brenda një periudhe 10 ditore të bëhen të gjitha përpjekjet për të patur një përgjigje, me synimin që kjo kërkesë të realizohet sa më parë.

Duke u ndalur tek nënshkrimi i Kontratës së re Kolektive të Punës, Zoti Pollo theksoi se nuk ka asnjë pengesë për këtë dhe shprehu angazhimin për të filluar menjëherë nga puna, duke rakorduar më parë në parim vijat kryesore të përmbajtjes së Kontratës dhe duke vënë në punë grupet përkatëse negocuese për të përgatitur një projekt që t'i afrohet sa më shumë plotësimit të kërkesave të të dy palëve. Duke patur parasysh që ky proces do të kërkojë një periudhë kohe të caktuar për negocime, në kushtet kur afati ligjor i Kontratës ekzistuese ka mbaruar, u ra dakord që, në zbatim të Kodit të Punës, palët të nënshkruajnë një Marrëveshje të përkohëshme për zgjatjen e efektshmërisë së Kontratës ekzistuese deri në nënshkrimin e Kontratës së re.

Ministri Pollo vlerësoi kërkesën për miratimin e Statusit të Mësuesit, duke e konsideruar atë një domosdoshmëri, sidomos në kushtet kur statusi ligjor i mësuesit është akoma larg statusit të punonjësve të shërbimit civil dhe shprehu angazhimin për të filluar menjëherë nga puna, duke besuar se miratimi i këtij dokumenti do të shërbejë, gjithashtu, edhe për rritjen e profesionalizmit të mësuesve, përmirësimin e etikës dhe rritjen e angazhimit të tyre në shkollë e në komunitet.

Në përfundim, zoti Genc Pollo theksoi se ai e vlerëson bashkëpunimin me sindikatat si një domosdoshmëri dhe do të kërkojë nga të gjitha strukturat partneritet real dhe efektiv në marrëdhëniet me sindikatat.

Nje liber shume i vlefshem per sindikatat

Nga Tryeza e Rrumbullakut per Librin "Sindikatat dhe Puna e Femijeve"

Ne kuadrin e nje programi qe FSASH eshte duke zbatuar, ne bashkepunim me Zyren e ILO-IPEC ne Tirane, keto dite u botua Libri "Sindikatat dhe Puna e Femijeve", i cili eshte nje instrument shume i rendesishem ne duart e drejtuesve sindikaliste dhe mesuesve ne pergjithesi, ne lidhje me eliminimin e punes se femijeve ne vendin tone.



Perkthimi, pershtatja dhe botimi ne gjuhen shqipe, ne nje liber te vetem, i shtate broshurave te Organizates Nderkombetare te Punes, ILO, me teme qendrore sindikatat kunder punes së femijeve nuk eshte nje veprim i vetem dhe as i shkeputur nga veprimtaria e sindikatave te arsimit ne Shqiperi, FSASH e SPASH, si edhe sindikatave te profesioneve te tjera, anetare te KSSH-se dhe BSPSH-se.

Botimi i ketij Libri, me materialet e pasura qe permban secila prej broshurave, me perfshirjen e pervojës, ndonese akoma modeste, te te gjithe faktoreve shqiptare e posaçerisht te sindikatave, per parandalimin e punes se femijeve, perben nje mbeshtetje te forte dhe inkurajim per te gjitha sindikatat, e posaçerisht per ato te arsimit, per t'u perfshire me me qartesi, pergjegjesi e vendosmeri ne procesin e parandalimit dhe eliminimit te punes se femijeve, per te hartuar politika dhe plane veprimi efikase, per te siguruar vijimesi e cilesi me te lartë krahasuar me punën e bere deri tani.

Botimi i ketij Libri eshte me vlera te shumaneshme, sepse ai do te perdoret nga drejtuesit dhe aktivistet sindikale, jo vetem ne aktivitetet qe kane te bejne me punen e femijeve, por edhe per shume çeshtje te tjera te veprimtarise sindikale.

Kjo gje u theksua edhe ne Tryezen e Rrumbullakut qe u organizua ne Tirane, ne lidhje me diskutimin e Projektit te ketij Libri, ku moren pjese drejtues te niveleve te ndryshme te dy sindikatave te arsimit, FSASH e SPASH, te disa Federatave te KSSH te angazhuara ne keto probleme, si ajo e Bujqesise dhe Ushqimit, Shendetesise dhe Tekstil Artizanatit, perfaqesues te Ministrise se Arsimit dhe asaj te Punes, specialiste te botimeve, si edhe perfaqesues te disa OJF-ve te angazhuara ne problemet e eliminimit te punes se femijeve.

Tryeza u drejtua nga Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi dhe Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Tirane, zonja Snezhi Bedalli.

Pas nje prezantimi te te dy drejtuesve te Tryezes, ne lidhje me angazhimin e FSASH-it dhe te ILO-IPEC ne Tirane per eliminimin e punes se femijeve, Sekretari i Pergjithshem i FSASH, Stavri Liko, beri paraqitjen e Librit, duke u ndalur sidomos tek nevojat per kete liber ne shqip, tek shpjegimi i permbajtjes se seciles prej shtate broshurave qe e perbejne ate dhe tek udhezimet ne lidhje me perdorimin e tij.

Qe ne fillim, ai theksoi se ka kohe qe edhe sindikatat shqiptare kane filluar te angazhohen per eliminimin e punes se femijeve dhe FSASH eshte ne krye te kesaj pune, duke synuar ne zgjerimin e angazhimit te saj dhe ne perfshirjen e sindikatave te tjera ne kete ceshtje.

Drejt ketij zgjerimi e angazhimi, sindikatat shqiptare kane nevoje per udhezues, por edhe per pervoja e praktika te mira, gje qe plotesohet, ne nje fare menyre, me ane te ketij Libri.

Duke u ndalur tek Broshura e Pare, me titull "Udhezues per Broshurat", ai theksoi se ajo jep udhezime se si mund te perdoren Broshurat ne vijim, ne punen dhe jeten e perditshme, ne seminare, ne punen studimore, ne integrimin e punes se femijeve ne programet e tjera te sindikatave etj. Ajo ka, gjithashtu, gjashte shembuj aktivitetesh, si model per seminaret ose aktivitete te tjera, ka nje liste te botimeve ne kuadrin e Projekteve te ILO dhe nje liste te materialeve qe mund te gjenden ne zyrat e IPEC.

Broshura e Dyte, me titull 'Politikat Sindikale dhe Planet e Veprimit Kunder Punes se Femijeve", e

shte "guri i themelit" per Broshurat qe vijojne. Ajo eshte baza per shume aktivitete qe mund te zhvillojne sindikatat, prandaj duhet te studiohet e para, kur mendohet te perdoren Broshurat. Ajo paraqet problemin e punes se femijeve aktualisht, paraqet punen e femijeve si nje çeshtje sindikale dhe shpjegon pse, shpjegon procesin e hartimit te politikave sindikale e te

Vijon në faqen 12

Nje liber shume i vlefshem per sindikatat

Vijon nga faqja 11

planeve te veprimit kunder punes se femijeve dhe jep shembuj konkrete te politikave dhe veprimeve sindikale te qendrave sindikale nderkombetare si ICFTU, EI, PSI, IUF.

Broshura e Trete, me titull "Gjetja e Fakteve dhe Informacioni mbi Punen e Femijeve" pershkohet nga ideja themelore se veprimet serioze te sindikatave mbi punen e femijeve duhet te bazohen mbi informacione te besueshme dhe sqaron se per çfare informacioni kane nevoje sindikatat, burimet e informacionit, aresyet pse punojne femijet, legjislacioni per punen e femijeve dhe veprimet sindikale qe duhet te ndermerren. Ajo jep, gjithashtu, udhezime se si mund ta mbledhim informacionin dhe sqaron se cfare mund te bejne sindikatat me informacionin e grumbulluar

Broshura e Katërt, me titull "Fushatat Kunder Punes se Femijeve", pasi ben nje historik te zhvillimit te Fushatave nga sindikatat ne keto 100 vjetet e fundit, sqaron se per cfare mund te ndermerret nje Fushate, jep nivelet e Fushatave, percakton detyrat kryesore qe duhen ndjekur per organizimin e nje Fushate dhe evidenton rendesine e publicitetit per Fushaten.

Broshura e Peste, me titull "Kontratat Kolektive Kunder Punes se Femijeve", ka te beje me Kontratat Kolektive, si mjeti tradicional i sindikatave dhe menyra kryesore e tyre per t'u lidhur me punedhenesit. Ajo thekson domosdoshmerine e zgjerimit te permbajtjes se kontratave, jo vetem per pagat, por edhe per sigurine e shendetin, pensionet,

bashkepunimin me administraten, punen e femijeve etj. Krahas trajtimit te rendesise se kodeve te sjelljes dhe iniciativave te tjera nderkombetare, ajo sqaron se cfare duhet te perfshihet ne nje marreveshje mbi punen e femijeve.

Broshura e Gjashte, me titull "Perdorimi i Standardeve te ILO per te Luftuar Punen e Femijeve" sqaron se cfare jane standardet nderkombetare te punes (rregullat qe percaktojne Konventat dhe rekomnadimet e ILO), cilat jane standardet themelore te punes (grupi prej 8 konventash mbi punen e detyruar, shperblimin e barabarte, mbi te drejten per t'u organizuar, mbi punen e femijeve:konventat 138 e 182 etj. Ajo komenton dhe jep shpjegime te pergjitheshme per disa prej tyre, sqaron procedurat e mbikqyrjes dhe ankimeve dhe boton tekstet e plota te Konventave Nr.138 e 182 dhe te Rekomandimeve perkatese, Nr. 146 dhe 190.

Broshura e Shtate, me titull "Marredheniet Tripaleshe Kunder Punes se Femijeve"

pershkohet nga ideja baze se per te arritur qellimet e tyre, sindikatat duhet te bashkepunojne me partneret sociale (punedhenesit, qeverine, (inspektoret e punes), si edhe te krijojne aleanca dhe rrjete, duke siguruar nje bashkepunim te ngushte me ILO-ACTRAV, ILO/EMP dhe ILO-IPEC.

Ne perfundim te prezantimit te vete, zoti Stavri Liko sqaroi se ne Liber jane perfshire edhe kater referenca nga pervoja dhe problemet ne vendin tone, te cilat jane:

Format e punes se femijeve ne Shqiperi (bazuar kryesisht ne raportin e perfaqesuesit te ICFTU, S. Grumiau, dhe IPEC, angazhimi dhe aktivitetet e FSASH dhe te KSSH e BSPSH per luften kunder punes se femijeve, legjislacioni shqiptar per luften kunder punes se femijeve,(ratifikimi i konventave, Kushtetuta, Kodi i Punes, VKM), si edhe veprimtaria e IPEC ne Shqiperi, Memorandumi 1999, fushat prioritare, programet kryesore, synimet per te ardhmen.

Ne vijim, u bene diskutime te shumta ne lidhje me permbajtjen e Librit dhe nevojen per disa permiresime te metejshme, sidomos per ceshtjet qe lidhen me pervojen dhe problemet ne vendin tone.

Kryetari i KSSH, zoti Kol Nikollaj, vleresoi botimin e ketij Libri dhe e konsideroi ate si instrument te rendesishem ne duart e sindikalisteve tane. Kryetari i Federates se Bujqesise dhe Ushqimit, zoti Alfred Xhomo, kerkoi qe te planifikohen me shume kopje per sindikatat ne baze, sidomos ne zonat rurale, ku problemiu i punes se femijeve eshte me shume i pranishem. Po keshtu, kryetari i Federates se Shendetesise, zoti Minella Mano propozoi qe ne Liber te zene me shume vend problemet qe lidhen me trajtimin e femijeve te fshatit dhe sidomos per Broshuren e Dyte te shikohet mundesia per t'u botuar ne sa me shume kopje, sepse eshte shume e rendesishme per drejtuesit dhe aktivistet sindikale.

Zv/Kryetari i SPASH-it, zoti Aleks Dushi, me te drejte, ngriti problemin e perfshirjes me te gjere te çeshtjeve qe lidhen me legjislacionin tone kombetar ne lidhje me parandalimin e punes se femijeve. Edhe aktivistja e SPASH-it, zonja Kozeta Berisha, sugjeroi qe problemi i perfshirjes se punes se femijeve ne negocimet qe pritet te fillojne me Ministrine e Arsimit per Kontraten Kolektive te Punes te mbahen mire parasysh, mbasi deri tani ky mjet i rendesishem i levizjes sindikale nuk eshte perdorur si duhet per kete çeshtje.

Zv/Kryetaret e FSASH-it Fatbardha Keço e Lumturi Mataj, si edhe drejtues te tjere lokale te kesaj Federate, si Osman Nika, Derall Tota etj, kerkuan qe ne Liber te paraqiten me gjere angazhimet e deritanishme te FSASH-it ne lidhje me problemet qe kane te bejne me punen e femijeve.

Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Tirane, zonja Snezhi Bedalli vleresoi punen e bere per pergatitjen e Librit, por nderkohe beri disa sugjerime qe kishin te benin sidomos me zgjerimin e informacionit mbi angazhimin e sindikatave shqiptare, bashkepunimin e tyre me ILO-IPEC dhe me Njesine per Punen e Femijeve prane Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale dhe me disa OJF qe jane aktive ne kete drejtim.

Pothuajse te gjithe diskutantet theksuan faktin qe ky liber eshte shume i vlefshem edhe per faktin se ai mund te perdoret si baze ne aktivitetet trajnuese qe duhet te organizojne sindikatat tona, jo vetem per çeshtjet qe lidhen me pune e femijeve, por edhe per probleme te tjera qe kane te bejne me veprimtarite efektive te sindikatave ne punen e tyre te perditeshme.

Arritjet jane te mira, por kerkohet me shume

Nga Konferenca e SPASH per rrethin e Krujes

Ne vazhdim te fushates se zgjedhjeve, edhe Sindikata e Pavarur e Arsimit ne rrethin e Krujes zhvilloi Konferencen e saj, ku merrnin pjese kryetaret e sindikatave te shkollave te cilet perfaqesojne nje shtrirje ne te gjithe rrethin. Shqetesues ishte fakti qe shume drejtore shkollash nuk i lejuan kryetaret e sindikatave te merrnin pjese ne kete Konferenece edhe pse ishin njoftuar nga ana e Drejtorise Arsimore te rrethit. Kjo tregon se nga ana e ketyre drjetoreve dhe vete Drejtorise Arsimore ka akoma mosnjohje dhe mosrespektim te Kontrates Kolektive te Punes dhe te partneritetit me sindikaten e arsimit.

Ne Konference Kryetari i Sindikates se Pavarur te Arsimit per rrethin e Krujes, zoti Bashkim Dushku, mbajti raportin ne emer te kryesise se sindikates, ku trajtoi gjeresisht aktivitetin katervjeçar te sindikates. Siç u theksua ne raport, nder problemet kryesore ka qene rritja e numrit te anetaresise, grumbullimi i kuotizacionit, rritja e rolit te sindikates ne shkalle rrethi ne mardheniet me Drejtorine Arsimore dhe te keshillave ne shkolla me drejtorite e shkollave perkatese.

Nga raporti doli se ne shume raste nuk eshte zbatuar kontrata kolektive nga ana e Drejtorise Arsimore, e cila ka sjelle shume shqetesime per Kryesine e sindikates, sidomos ne lidhje me levizjen e kryetareve te sindikatave nga njera shkolle ne tjetren. Gjithashtu raporti i bente nje analize te thelle zhvillimit te greves se fundit, ku thekshej presioni i ushtruar nga Drejtoria Arsimore dhe drejtuesit e shkollave ndaj mesuesve dhe drejtuesve te sindikatave.

Nga analiza doli se problem shqetesues eshte, gjithashtu, se shume mesues jane te regjistruar ne te dyja sindikatat, me gjithe perpjekjet qe kane bere te dy kryetaret ne shkalle rrethi per t'i dhene nje zgjidhje ketij problemi.

Ne Konference u vleresua ne pergjithesi puna e bere deri tani, por diskutantet theksuan se mundesite jane akoma me te medha dhe puna duhet te shtrihet ne te gjithe rrethin, nepermjet nje aktivizimi me te mire te te gjitha anetareve te Kryesise.

Konferenca theksoi se per te ardhmen mbetet shume per te bere, me synimin per t'u shtrire ne te gjitha shkollat. Ne diskutimin e vete, sindikalisti i vjeter z. Ramiz Hushi, tha se ne lidhje me kuotat ne duhet te perdorim menyren me mandate, nese nuk zbatohet kontrata kolektive per mbajtjen e tyre me bordero. Ne duhet te marrim te gjitha masat qe sindikata te rritet ne anetaresi dhe te mos jemi te mefshte, sepse mesuesit kane nevoje per sindikaten sidomos ne kushtet e varferise dhe te presioneve qe behen ndaj mesuesve, tha ne diksutimin e tij zoti Frrok Gjoka.

Mbas diksutimeve, sipas rendit te dites, u kalua ne zgjedhjen e Kryesise e te kryetarit te sindikates dhe miratimin e detyrave per te ardhmen. Kryetar i Sindikates se Pavarur te Arsimit per rrethin e Krujes, u rizgjodh zoti Bashkim Dushku, i cili ne fjalen e vete premtoi perkushtim ne kryerjen e kesaj detyre, duke theksuar se do te punoje me synimin qe mbi 400 mesues te jene anetare te kesaj sindikate, me kuotizacion, nga 600 mesues qe ka ne shkalle rrethi.

Ne Konference mori pjese edhe Presidenti i BSPSH-se, zoti Gezim Kalaja, i cili ne fjalen e vete pershendetese vleresoi punen e bere dhe kerkoi qe ne te ardhmen sindikata e arsimit e rrethit te Krujes te jete me e fuqishme per te realizuar misionin qe ajo ka ndaj mesuesve te ketij rrethi. Ai premtoi se edhe ne te ardhmen BSPSH do te mbeshtese SPASH ne te gjitha veprimtarite e saj.

Ne Konference moren pjese gjithashtu Zv/Kryetari i SPASH, zoti Defrim Spahiu dhe Kryetari i BSPSH-se per rrethin e Krujese, zoti Engjell Sollaku, te cilet shprehen zotimet e tyre per t'i qendruar me afer dhe ndihmuar sindikaten e arsimit te ketij rrethi.

Dëfrim Spahiu
Sekretar i Përgjithshëm i SPASH

ME KËRKESA GJITHNJË E MË TË LARTA

Në shkollën e mesme "Gjergj Kastrioti", Durrës

1

Në afërsi të brigjeve të Detit Adriatik, aty ku dëgjohet mirë shushurima e valëve të tij, ndodhet shkolla e mesme "Gjergj Kastrioti" e Durrësit. Sa e sa breza nxënësish e mësuesish kanë kaluar pranë Amfiteatrit gjigand e nëpër objektet e lashta arkeologjike dhe janë ulur në bankat e kësaj shkolle, me emër të mirë jo vetëm në këtë qytet, por dhe në shkallë vendi. Sërish sivjet aty u mblodhën mbi 1100 nxënës, bashkë me 41 mësues të tyre. Menjëherë të bie në sy se të gjithë ata janë pajisur me uniformë të bukur shkollore.

Në vitin e kaluar arsimor ky kolektiv shënoi arritje të kënaqshme në procesin mësimor-edukativ. Kalueshmëria ishte rreth 90 për qind dhe nota mesatare mbi 6,7. Nga tri maturat e profilit shoqëror dhe tri të profilit natyror, me 218 nxënës, të gjithë morën diplomat. Shumica e tyre po i ndjekin studimet e larta në universitete të ndryshme, brenda e jashtë vendit, në profilet e pëlqyera prej tyre, si mjekësi, ekonomi, drejtësi, informatikë etj. Ndërsa vazhdues të tyre, nxënësit e shtatë maturave, shpresojnë që vitin pasardhës akademik në këtë qytet të hapë dyert shkolla e lartë, për të cilën është debatuar aq shumë kohët e fundit.

Kur u ndodhëm në mjediset e kësaj shkolle, kishte rënë zilja dhe nxënësit ndodheshin në mësim. Nëpër korridore kishte qetësi dhe dëgjoheshin vetëm fjalët e mësuesve ose përgjigjet e nxënësve. Në zyrën e drejtorisë gjetëm stafin, drejtoreshën Amelika Dollaku dhe zv.drejtoreshat Fatmira Qesja e Mamica Kapaj. Ato po konsultoheshin me njëratjetrën për çështje aktuale të mbarëvajtjes së punëve në shkollë. Padashur, mendja na shkoi në ndonjë kolektiv tjetër shkollor, i cili "komandohet" nga meshkujt. Sigurisht, ndjen kënaqësi, kur këtu njihesh me arritjet dhe objektivat që synohen. Pra, këto drejtuese të afta nuk u lënë asgjë

Vijon në faqen 14

ME KËRKESA GJITHNJË E MË TË LARTA

Në shkollën e mesme "Gjergj Kastrioti", Durrës

Vijon nga faqja 13

mangut "burrave".

"Është për t'u shënuar se sivjet kemi një kolektiv pedagogjik të kualifikuar dhe të gatshëm të arrijë të gjitha objektivat tona, tregon znj. Dollaku. Tani dhe kushtet janë më të përshtatshme për edukim e mësim, pasi nxënësit kanë laboratore kimie e fizike, biologjie e informatike, sipas standardeve bashkëkohore. Dy nga synimet tona kryesore janë: Mbështetja për rezultate të larta e për mundësi shkollimi nga të gjithë nxënësit dhe nxitja e shpirtarit krijues, inisiativës dhe imagjinatës së tyre".



Më tej njihemi edhe me hollësi të këtyre synimeve. Këto janë të lidhura ngushtë me cilësinë, që nesër nxënësit të konkurrojnë e të fitojnë të gjithë dhe të zbulohen talentet në çdo fushë. Mbi këtë bazë janë hartuar planet e drejtorisë, komisioneve lëndore e çdo mësuesi. Kujdes i veçantë do të tregohet për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive kulturore e sportive, ku nxënësit do të shpalosin aftësitë e prirjet e tyre dhe do t'i çojnë ato më tej. Se edhe në vitin e kaluar ata morën pjesë në veprimtari të ndryshme, lokale e kombëtare. Kështu, në olimpiadën e matematikës maturantët merituan vend të parë e të tretë. Me dinjitet u përfaqësuan dhe në olimpiadën ballkanike. Vende nderi zunë edhe në veprimtaritë kulturore e sportive.

Ashtu si deri tani, edhe në të ardhmen, veprimtaritë në këtë shkollë vlerësohen, jo vetëm për argëtimin dhe kalimin e kohes së lirë në mënyrë të kulturuar, por dhe si rrugë frytdhënëse për t'i parandaluar e mënjanuar dukuritë e padëshiruara, siç janë alkoli e droga etj. Këtij qëllimi i shërbeu edhe aksioni masiv i nxënësve për mbledhjen e shpërndarjen e ndihmave te njerëzit më në nevojë, me rastin e Ditës së Kryqit të Kuq. Moresëlënëse ishin sivjet veprimtaritë artistike, të zhvilluara në shkollë e në qytet me rastin e 600-vjetorit të Skënderbeut, emrin e të cilit mban me nder kjo vatër edukimi e mësimi. Përgatitje të shumta po bëhen tani për veprimtaritë, që do të organizohen me rastin e festave të Nëntorit të këtij viti. Për t'u shënuar është konkursi në fushën e historisë dhe traditave atdhetare e liridashëse të popullit tonë.

2

Në ndihmë të realizimit të detyrave të shumta në procesin mësimor-edukativ janë dhe sindikatat, që veprojnë në këtë shkollë. Veprimtarët e tyre bashkëpunojnë dhe kanë gjetur "gjuhë" të njëjtë me drejtorinë, si për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe në organizimin e zhvillimin e të gjitha veprimtarive, brenda e jashtë mureve të shkollës. Ata janë bashkë në nisma e aksione të ndryshme, por dhe me rastin e festimit të ditëlindjeve të anëtarëve të kolektivit ose në ceremonitë për daljen e ndonjërit në pension etj.

Me kujdes është punuar për njohjen dhe përhapjen e përvojës së përparuar. Se këtu ka shumë mësues të talentuar në profesionin e tyre, si: Nora Dervishi (matematikë), Xhavit Zalla (fizikë), Hasan Ulqini (letërsi), Liliana Gjika (ekonomi tregu), Elona Staka (gjeografi) e të tjerë. Ne parë dhe orë mësimi, që zhvillonin me maturantët Diana Kacani, në kimi e Vilma Nasto, në biologji.

Gjithashtu, në ballë të arritjes së objektivave të caktuara mbodhen këshilli i prindërve, Bordi i shkollës dhe Qeveria e Nxënësve. Në programet e punës dhe në veprimtarinë e tyre ndihet shqetësimi që çdo gjë të ecë si "sahat", pra asgjë të mos çalojë. Kështu, ndër të tjera, prindërit e nxënësve kanë ndihmuar për lyerjen e lokaleve, pasurimin e bibliotekës, ndërtimin dhe plotësimin e stendave të ndryshme, ngritjen e këndit të Flamurit etj. Prandaj dëgjon të flitet me respekt për ndihmesën e dhënë nga firmat e ndërtimit dhe Përparim Tartari, Jonuz Kasa e të tjerë.

Jehonë i ka bërë jetës në edukim e mesim dhe ka nxitur talentet e reja gazeta periodike, me emrin "Rreze rinore". Por është dashur të kalohen dhe vështirësi financiare për botimin e rregullt të saj.

Kjo shkollë e ka zgjeruar bashkëpunimin edhe jashtë mureve të saj, me simotra në Shqipëri, Kosovë e Mal të Zi. Kështu, ndër të tjera, lidhje të mira mbajnë me kolektivin e mësuesve dhe nxënësve të shkollës së mesme të përgjithshme "Petro Nini Luarasi" të Tiranës. Në takimet e vizitat e ndërsjellta janë njohur me përvojën e njëritjetrit, janë forcuar lidhjet shpirtërore etj.

...Një herë tjetër, përsëri do të njihemi nga afër me jetën e këtij kolektivi mësuesnxënës. Por jemi të bindur se arritjet e tyre do të jenë më cilësore e më të larta. E themi këtë se përkushtimi i tyre nuk mungon, se të gjithë së bashku punojnë e veprojnë për një qëllim: edukimin, aftësimin dhe përgatitjen e brezit të ri për të përballuar me sukses sfidat e përballjes me kërkesat e mijëvjeçarit të ri dhe të bashkësisë evropiane.

Murat Gecaj

Të reja shkencore



SHIKO MAMI, PA GJILPËRA

I urreni shiringat? FluMist, një vaksinë e re alternative për viruset e gripit që bën që miliona njerëz në mbarë botën të zënë krevatin çdo dimër, merret si një ilaç nga hunda. E aprovuar nga organet kompetente këtë qershor për njerëz të shëndetshëm të moshës 5 deri në 49 vjeç, ajo lëshon një sërë antitrupash në pjesën e sipërme të aparatit të frymëmarrjes që është edhe dera e preferuar e hyrjes së gripit.
Vështirësia është se FluMist kushton sa trefishi i një shiringe normale dhe kompanitë e sigurimit të shëndetit nuk e marrin përsipër siguracionin e saj. Çmimi i momentit është 50 dollarë për një dozë.

MIKROFONI SPUTMIK



Demokraci është dëgjimi i zërit të të gjithëve, por kjo nuk është e lehtë kur ka vetëm një mikrofon. Provoni Sputmik, një pajisje plot ngjyra e projektuar për të lejuar këdo që dëshiron, të marrë fjalën në një takim apo leksion. I krijuar nga një bashkëpunim i Design Continuum në Boston dhe M.I.T, Sputmik (një lojë fjalësh për Sputnik) është një mikrofon tërësisht pa kabllo me përmasat e një topi basketbolli, i lehtë për t'u mbajtur, në mënyrë që grupet e njerëzve të mund ta përdorin në një koncert rroku përshembull, duke e kaluar atë mbi kokë si një top volejbolli ose edhe ta hedhin nga njëri tek tjetri.

DORASHKA E TË VERBËRVE

Kur 18 vjeçari Ryan Patterson, gjimnazist, pa një grua të shurdher të porosiste ushqim në një restorant, ai pati një moment "Eureka". Pse të mos krijonte një pajisje që përkthente gjuhën e shenjave në tekst? I armatosur me këtë ide dhe duke përdorur një dorashkë golfi prej lëkure, Patterson krijoi një pajisje, që ndjen lëvizjet e dorës së atij që e mban atë dhe ia transmeton ato si fjalë bashkë-biseduesit nëpërmjet një monitori të vogël pa kabllo që mbahet në dorë prej tij. Kjo shpikje i dha Pattersonit çmimin e parë në një konkurs shkence dhe teknologjie, zhvilluar nga Siemens.



DHËMBI TELEFON

Jeni të lodhur duke u detyruar të mbani në rripin tuaj telefonin kudo që shkoni? Në të ardhmen ju mund të mos e keni këtë problem. Dy studiues britanikë kanë krijuar një prototip të "dhëmbit telefon" që mund të futet brenda një dhëmballe dhe mund të marrë telefonata. Sinjalet përkthehen në dridhje që udhëtojnë nga dhëmballa në kafkë dhe në veshin tuaj të brendshëm, ku vetëm ju mund t'i dëgjoni. Pajisje shumë e dobishme për t'u dhënë instruksione spiunëve dhe jo aq e dobishme për ne, sepse, ndërkohë që dhëmbi ynë na flet, ne nuk mund t'i përgjigjemi.



Keshilla praktike

SHTATË MËNYRA PËR TË ULUR STRESIN NË PUNË

1. Punoni për gjërat e rëndësishme.
Kjo mund të tingëllojë si e qartë, por shumë prej nesh janë të joshur të punojnë për detyrat e lehta në fillim, në mënyrë që të kemi një ndjenjë realizimi. Por kujdes, koha e harxhuar për këto detyra "të lehta" mund të shtohet me shpejtësi, duke krijuar edhe më shumë stres kur vihet re se nuk ka mbetur kohë e mjaftueshme për punët e rëndësishme.

2. Mbani një "ditar aktivitetesh"
Kjo do t'ju ndihmojë të kuptoni se me se po e harxhoni kohën. Sa herë filloni dhe mbaroni një aktivitet të ri, duke përfshirë pushimet, shënoni orën. Shumë punonjës që kanë një orar të ngarkuar kanë mësuar ta bëjnë këtë automatikisht. Nëse nuk jeni mësuar të regjistroni kohën tuaj, mund të jetë thjesht një jopërshtatje, por, nëse do të arrini ta bëni këtë, në pak ditë do të jeni në gjendje të vini re çdo aktivitet që ju merr shumë kohë dhe për të cilin ju nuk keni qenë të vetëdijshëm.

3. Vendosni objektiva ditore
Kur të planifikoni kohën tuaj, përfshini diçka të papritur që mund të dalë dhe vendosni një orar ku mund të mbështeteni për ta përfunduar atë. Për të pakësuar stresin e arritjes së afatit përfundimtar të vendosur nga vetë ju, evitoni të bëni premtime deri sa puna të ketë përfunduar. Nëse duhet të angazhoheni për një datë të caktuar, tregohuni të kujdesshëm. Nëse premtoni shpesh për të përfunduar një punë në një afat të përcaktuar dhe e dorëzoni atë më shpejt, ju mund të fitoni një emër të mirë dhe në të njëjtën kohë të ulni stresin.

4. Tregohuni i sjellshëm me veten tuaj
Synoni të arrini ose edhe të tejkaloni ato që prisni nga vetja, por mos u përpiqni të arrini përsosmërinë. Aty ku është e mundur, ngarkoni dikë tjetër me detyrat rutinë edhe nëse mendoni se ju mund t'i bëni ato më mirë se kushdo tjetër.

5. Evitoni ndërprerjet
Vetëm nëse nuk detyroheni të jeni gjithmonë të disponueshëm, zgjidhni një orë gjatë ditës kur t'iu përgjigjeni telefonatave dhe postës elektronike. Gjatë kohës tjetër lini sekretarinë të marrë mesazhe. Mund të krijoni edhe një përgjigje automatike për të informuar njerëzit që mesazhi i tyre u mor. Nëse mesazhi juaj thotë se do t'u përgjigjeni brenda 24 orësh kjo do të ndalonte dërgimin e një mesazhi të përsëritur gjatë kësaj kohe.

6. Mos lini problemet e të tjerëve të ndikojnë mbi ju
Ashtu siç thotë edhe Richard Carlson, shkrimtar, "nëse dikush ju hedh topin, pa qenë i përfshirë në lojën tuaj, ju nuk kini pse ta prisni ate". Nëse dikush vjen tek ju me një problem që nuk është i juaji, përpiquni të limitoni kontributin tuaj me këshilla, në vend që të përfshiheni edhe ju në këtë gjë.

7. Kur ndjeheni të shqetësuar, thuajeni
Kompanitë duan të mbajnë punëtorë të dobishëm, kështu që shumica e drejtorëve do të dëshironin ta dinin, kur jeni në vështirësi. Megjithatë, në vend që të thoni "nuk mund ta bëj atë", ofroni disa zgjidhje të mundshme. Për shembull, nëse nuk do të jeni në gjendje të përfundoni një raport të rëndësishëm në afatin e përcaktuar, ju mund t'i ofroni drejtorit: (1) një version të përmbledhur në afatin e përcaktuar, (2) përfundimin e raportit komplet në një datë të mëvonshme, ose (3) arritjen e afatit nëse ndihmoheni nga kolegët ose nga një staf i përkohshëm.
Këto teknika ndoshta nuk do të ndihmojnë për të shijuar kohën e lirë ashtu si kishin parashikuar futuristët. Por ato mund ta bëjnë punën tuaj më të menaxhueshme dhe madje mund të ulin edhe stresin aq sa për shkuar për të pirë një kafe me dopio qumësht.

Përgatiti fagen Eriona Vangjeli

Tribuna sindikale

